

Të Kuptuarit e Braktisjes dhe Nevojës për Rivendosjen

MANUALI I SEMINARIT PËR DHATËN E RE

Studioji fragmentet e shkrimeve të shenjta dhe thënien në vijim nga Presidenti Rasëll M. Nelson dhe më pas përgjigju për pyetjet më poshtë.

- 1 Nefi 13:24–28: Nefi sheh në vegim atë që do t’u ndodhte të vërtetave të rëndësishme në Bibël.
2. Amos 8:11–12: Amosi profetizon për një uri shpirtërore që do të vinte.
3. Veprat e Apostujve 20:29–30: Pali paralajmëron se anëtarët e Kishës së Shpëtimtarit do të largoheshin nga ungjilli.
4. Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim:



“Perëndia ynë i gjallë është një Perëndi i dashur! Ai do që fëmijët e Tij ta njohin Atë dhe Jezu Krishtin, të cilin Ai e dërgoi! Dhe Ai do që fëmijët e Tij të fitojnë pavdekësi dhe jetë të përjetshme!

Për këtë qëllim të lavdishëm, misionarët tanë japin mësim rreth Rivendosjes. Ata e dinë se rreth 2.000 vite përpara, Zoti krijoi Kishën e Tij. Pas kryqëzimit të Tij dhe vdekjes së Apostujve të Tij, njerëzit e ndryshuan Kishën dhe doktrinën e saj. Atëherë, pas brezash errësire shpirtërore dhe sikurse u parashikua nga profetë të mëparshëm, Ati Qiellor dhe Jezu Krishti rivendosën Kishën, doktrinën e saj dhe autoritetin e priftërisë së saj. Në saje të asaj Rivendosjeje, njohuria dhe ordinancat thelbësore për shpëtimin dhe ekzaltimin janë përsëri të disponueshme për të gjithë njerëzit. Në fund, ai ekzaltim e lejon secilin prej nesh të jetojë me familje[n e vet] në praninë e Perëndisë dhe të Jezu Krishtit përgjithmonë!” (Rasëll M. Nelson, “Kapeni Valën”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2013, f. 46)

- Çfarë mësove rreth Braktisjes së Madhe nga këto fragmente të shkrimeve të shenjta dhe nga thënia e Presidentit Nelson?
- Çfarë mësove rreth Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit nga këto mësimet?
- Bazuar tek ajo që mësove, përse ishte e nevojshme Rivendosja?